



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:057622

Datë: 26.01.2024

Numri i dokumentit: 05248134

A.nr.5282023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditësit B.. Sh.. nga fshati G., komuna e F., kundër të paditurës Ministra e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Njoftimit të datës 10.01.2023, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 16.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET padia dhe kërkesëpafia e paditësit B.. Sh.. nga fshati G., komuna e F., si e bazuar.

II. ANULOHET Njoftimi i datës 10.01.2023 dhe DETYROHET e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh me vendim të vendos në lidhje me kërkesën e palës paditëse dhe të njëjtin t'ia dorëzoj palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 06.03.2023 ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar duke kërkuar anulimin e vendimit të goditur me padi. I propozon Gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar dhe detyrimin e të paditurës për kompensimin e pagesave në mënyrë retroaktive.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi deklaroi: *“Mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e njoftimit të atakuar me padi”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Pas administrimit të provave konsiderojmë se kërkesëpadija e paditësit është e vërtetuar në tërësi, andaj kërkoj nga gjykata, kompensimin në mënyrë retroaktive dhe detyrimin e të paditurës për nxjerrjen e vendimit”*.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 17.07.2023 e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke pretenduar se pagesa retroaktive nuk mund të realizohet pasi që kërkesa për pension kontributiv është paraqitur me datën 04.11.2022 ku nga kjo datë i është njohur e drejta në fjalë, ashtu siç është e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 07/2015 (MPMS), neni 11, paragrafi 2. I propozon Gjykatës që të refuzojë padinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: njoftimi i dt.10.01.2023, vendimi i dt. 09.11.2022 dhe 13.08.2020, kërkesa e dt.16.12.2022, kërkesa për pension kontributiv dt.04.11.2022, diploma e kryerjes së provimit përfundimtar e dt.27.08.1975, librezja e punës e dt.27.05.1974, formulari për aplikim pa datë, vërtetimi nga Inspektorati i Arsimit i dt.23.07.2020, vërtetimi i SHFMU i dt.23.07.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e pretendimeve të palës paditëse në raport me provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Nga akti administrativ i kundërshtuar, gjykata vëren se e paditura nuk ka marrë asnjë vendim rreth kërkesës së paditësit, përkatësisht ankesës së tij, por në vend të kësaj, kishte nxjerrë Njoftimin të datës 10.01.2023.

Gjykata gjeti se me vet faktin se e paditura ka nxjerrë shkresën me titullin “Njoftim” e jo vendimin, e njëjta i është shmangur vendimmarrjes meritore dhe ka shkelur nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”*. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se në rastin konkret kemi të bëjmë me paligjshmërinë e aktit administrativ të përcaktuar sipas nenit 52, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në riprocedurë e mbi bazën e nenit 132 të LPPA-së, organi i paditur obligohet të rishqyrtoj kërkesën e paditësit, të nxjerr Vendim të drejtë dhe të ligjshëm, me të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 47 të LPPA-së, të marr në shqyrtim të gjitha provat e prezantuara nga pala paditëse e veçanërisht zbatimin e plotë të Parimit të pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme si dhe Parimin e administratës së hapur, të përcaktuar në nenin 7, respektivisht nenin 8 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Organi i paditur, detyrohet para së gjithash që ankesën ta vlerësoj mbi bazën e pranueshmërisë së saj, ashtu siç kërkohet me nenin 131, paragrafin 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kjo nënkupton vlerësimin e organit të paditur nëse i njëjti është kompetent për të shqyrtuar meritat e ankesës, e në rast të kundërt, pra kur organi i paditur vlerëson se ligji apo aktet nën-ligjore specifike i pamundësojnë vlerësimin e ankesës mbi baza meritore, të konsideroj marrjen e vendimit procedural sa i përket lejueshmërisë së ankesës.

Organi i paditur obligohet që të shmangë përdorimin e gjuhës së përgjithësuar juridike në vendimin e ri, ashtu që pasi të ketë trajtuar ankesën e paditësit, pavarësisht rezultatit të vendimit që do ta merr, të udhëzoj drejtë paditësin në të drejtën e tij për t’u ankuar apo për të ngritur padi në gjykatën kompetente, lloji i së cilës duhet të përcaktohet nga vet e paditura.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar, ndërsa në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë.

Vendimi në lidhje me shpenzimet e procedurës, u mor konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë, në kuptim të nenit 5 lidhur me nenin 44.2, dhe 46 par. 3 të Ligjit për konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.528/2023, datë: 16.01.2024

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.